


**Miratohet krijimi i Këshillit Koordinues të Arsimitarëve në Diasporë, çfarë parashikon vendimi i qeverisë**

Këshilli i Ministrave ka miratuar propozimin e Ministrisë së Shtetit për Diasporën për krijimin e Këshillit Koordinues të Arsimitarëve në Diasporë. Ky Këshill do të funksionojë si një strukturë konsultative pranë Qendrës së Botimeve për Diasporën. Këshilli Koordinues i Arsimitarëve në Diasporë do të mbështesë dhe nxisë politikën e arsimit dedikuar komuniteteve shqiptare në Diasporë. Ky këshill nëpërmjet konsultimit dhe marrjes së informacionit nga strukturat përgjegjëse shtetërore për mësim-dhënie në Diasporë ka të drejtë të bëjë propozime për çështjet të cilat kanë të bëjnë me interesat e arsimit në diasporën shqiptare.

**Vota e Diasporës Shqiptare**

Të interesuarit për të drejtën e votës në migracion mund të gjejnë propozimet që i janë dërguar Komisionit të Reformës Zgjedhore.

**Angazhimi i investitorëve në vendlindje, nis projekti "Connect Albania"**

Prezantohet platforma, "Connect Albania", një model i njohur ndërkombëtar për vendet me Diasporë të konsiderueshme. Ai synon angazhimin në vendlindje të investitorëve me angazhimin e diasporës shqiptare. "Connect Albania" është një program i ri i cili do të përdoret në Shqipëri dhe po prezantohet në një takim online të organizuar nga Zyra e IOM në Tiranë, në kuadrin e Programit "Angazhimi i Diasporës Shqiptare në zhvillimin social dhe ekonomik të Shqipërisë". I pranishëm në aktivitetin promovues ministri i Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko tha se ky projekt i jep më shumë ngjyrë ditës kombëtare të Diasporës, duke e konsideruar një vlerë të shtuar për Diasporën shqiptare.

**Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës**

është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionale e ndryshme në Diasporë

[rrjetiprofessionisteve.al](http://rrjetiprofessionisteve.al)

**Dita Kombëtare e Diasporës, urimi i ministrit Pandeli Majko**

Në 18 Dhjetor, në Ditën e Diasporës dhe Dita Ndërkombëtare të Emigrantëve, uroj me zemër të gjithë motrat dhe vëllezërit tanë të Diasporës kudo ku janë nëpër botë. Diaspora shqiptare ka luajtur një rol vendimtar në Rilindjen Kombëtare dhe fitimin e Pavarësisë së Shqipërisë dhe Kosovës. Pa përpjekjet e patriotëve shqiptarë në Diasporë, gjuhë identiteti dhe pavarësia jonë do të ishin rrezikuara. Diaspora e Re shqiptare është ndër Diasporat më aktive në shumë shtete të Evropës. Kontributi i përfaqësuesve të Diasporës sonë, si asaj të mëparshme dhe asaj të re në vendet ku ndodhet është tërësor, në të gjitha sferat e aktivitetit shoqëror dhe ekonomik. Shqiptarët e Diasporës janë shquar dhe shquhen për punë intensive dhe të përkushtuar, aftësi krijuese, integritet, profesionalizëm dhe sjellje të përgjegjshme në jetën në komunitet. Kontributi i tyre në Atdhe është i jashtëzakonshëm. Dijet që kanë sjellë në Shqipëri kanë mundur suksesin e qindra mijëra nismave në fushat shoqërore, kulturore e artistike, por edhe të dhjetëra mijëra sipërmarrjeve në ekonomi. **Lexo të plotë këtu:**

**DIGJITALIZIMI I VEPRAVE SHQIPTARE****Digjitalizimi**

Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen

[adld.al](http://adld.al)

**Aktiviteti institucional në një libër, botohet Strategjia Kombëtare 2018-2024**

I gjithë aktiviteti institucional për zbatimin e planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, në marrëdhënie me diasporën shqiptarë tashmë është i përmblodhur në librin "Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit 2018-2024". Në 1 janar 2021 hyn në fuqi strategjia e re kombëtare dhe plani i veprimit 2021-2025. Botimi i librit "Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit 2018-2024" është një dokumentim i veprimit të strategjisë së "vjetër" për politikën shtetërore për diasporën shqiptare. Ky libër botohet nga Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe ndahet në dy pjesë: Strategjia Kombëtare e Diasporës dhe Plani i Veprimit në periudhën 2018 - 2024. Përmblodhja vjetore e buletineve 3 mujore në zbatimin e masave të planit të veprimit të ndara sipas viteve.

**Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"**

App store: [këtu](#) Play store: [këtu](#)

**Publikohet raporti "Diaspora shqiptare në shifra", INSTAT: Ja sa shqiptarë jamë nëpër botë**

INSTAT" ka publikuar raportin e përvitshëm "Diaspora shqiptare në shifra", në kuadër të Strategjisë së Diasporës. Sipas këtij raporti për vitin 2020 bazuar në vlerësimet e tërthorta, numri i shqiptarëve të larguar pas vitit 1990 llogaritet të jetë rreth 1,68 milionë shtetas jashtë vendit ose rreth 37% të shtetasve shqiptarë.

**"Raporto" problemin në çdo kohë në Ambasadalme**

App store: [këtu](#) Play store: [këtu](#)

**Takimi i përbashkët, urë bashkëpunimi mes QSPA dhe Instituti të Historisë**

Stafi akademik i Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët dhe Instituti i Historisë kanë organizuar një takim të përbashkët për të shkëmbyer mendime lidhur me veprimtari të përbashkëta mes dy institucioneve për vitin 2021. Në takim ishin të pranishëm përgjegjësjat e Departamentit të Historisë Bashkëkohore në Institutin e Historisë, Prof. Asoc. Sonila Boçi, studiuesit, Prof. Diana Kastrati, Dr. Silvana Nini, Dr. Ardita Reçi, Dr. Dorina Arapi, Dr. Edmond Cane dhe Dr. Artan R. Hoxha. U vendos që idetë e diskutuara në këtë tryezë të materializohen në një platformë bashkëpunimi, e cila do të bëhet publike në janarin e vitit që vjen.

**QBD sjell në dy gjuhë shqip-italisht "Ushtari prej plumbi"/ "Borëbardha"**

"Ushtari prej plumbi"/ "Borëbardha" përralla mjaft të dashura për fëmijët vijnë në një botim dygjuhësh shqip-italisht, një projekt i Qendrës së Botimeve për Diasporën. Ata janë pjesë e serisë "Klasikët Dygjuhësh". "Ushtari prej Plumbi" shkruar nga autori Peter Holeinone, është historia e një ushtari prej plumbi, i cili megjithëse ishte derdhur në metal si shokët e tij, tregoi se kishte një zemër të ndjeshme. Fjandi i tij dhe balerina, ndryshon aq shumë nga përrallat e tjera. "Borëbardha", përralla më e famshme e Vëllezërve Grimm në të gjithë botën, vjen për lexuesit e vegjël në këtë libër në shqip dhe në anglisht.